



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 21.07.20 Ref.: 983/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 82-të, të mbajtur më 25.06.2020, mori:

V E N D I M

- I. Nuk riakreditohet Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" në nivel institucional.
- II. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" për vitin akademik 2019 – 2020 deri në periudhën e riakreditimit të dytë institucional.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional. AKA ka organizuar vlerësimin me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli", me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional. Vlerësimi për riakreditim institucional është realizuar me 29.05.2020 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol, Janez Vogrinc dhe Ketj Tsotniashvili.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vlerësimit, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli” nuk përmbushë kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Nga gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli” i plotëson substancialisht tre (3) (Misioni publik dhe objektivat institucionale; Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi; Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit), pjesërisht gjashtë (6) (Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Menaxhimi i cilësisë; Mësimdhënia dhe të nxënit; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse; Burimet dhe hapësirat; Bashkëpunimi institucional); ndërsa nuk plotëson tre (3) (Hulumtimi; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional).

Sa i përket kapitullit të standardeve “Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike”, në raportin e vlerësimit ekspertët e akreditimit kanë konstatuar se Kolegji ka një kod të etikës i cili kërkon një standard të lartë të sjelljes në të gjitha fushat e aktivitetit të Kolegjit, megjithëse vërehen mospërputhje dhe nevojë për përmirësim. Për shembull, ekspertët kanë gjetur se programi antiplagjiarizëm është miratuar rishtazi dhe nuk ka evidencë se është përdorur shumë. Sipas informatave të marra gjatë intervistave në ditën e vizitës ekspertët kanë vërejtur se për identifikimin e rasteve të plagjiaturës Kolegji mbështetet shumë në intuitën ose në veprimet individuale të stafit akademik. Pos kësaj, disa anëtarë të stafit akademik kanë publikuar në revista që janë në listën e revistave të dyshimta (*predatory journals*). Sipas ekspertëve nuk vërehen procese dhe mekanizma të qarta për zbatimin e Kodit të Etikës në Kolegji.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Menaxhimi i cilësisë”, ekspertët kanë deklaruar se Kolegji Tempulli ka zhvilluar një Kornizë Rregullative për Sigurimin dhe Menaxhimin e Cilësisë. Informacioni i ofruar në këtë rregullore është i pa strukturuar, dhe nuk përcakton në mënyrë të qartë proceset, mekanizmat, instrumentet dhe përgjegjësitë e individëve dhe njësive të përfshira në sigurimin e cilësisë si dhe marrëdhëniet mes tyre. Sipas ekspertëve, rregullorja ofron informata të panevojshme të cilat nuk janë relevante për të përshkruar sistemin e sigurimit të cilësisë. Rregullorja thotë se standardet për politika dhe procedura mbikëqyren nga ekupe të brendshme të auditimit dhe miratohen nga agjenci të jashtme për vlerësime ISO. Megjithatë, ekspertët potencojnë se Kolegji Tempulli nuk ka certifikatë ISO dhe në planin strategjik nuk është paraparë asnjë vlerësim ISO. Sipas ekipit të ekspertëve, në kornizën rregullatorë për sigurim të cilësisë dhe në SER thuhet se Kolegji ka të themeluar komisionin për cilësi, megjithatë studentët dhe stafi akademik nuk kishin dijeni për ekzistimin e një komisioni të tillë.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Mësimdhënia dhe të nxënit” ekspertët në raportin e vlerësimit kanë deklaruar se Kolegji Tempulli nuk ka një politikë që përcakton procedurën për zhvillimin, miratimin dhe rishikimin e programeve akademike. Sipas raportit të vet-vlerësimit por edhe sipas përfaqësuesve të Kolegjit, kolegji Tempulli organizon ofrimin e programeve në dy forma: në formë të rregullt dhe me korrespondencë. Nga 84 student me status aktiv, shumica e tyre (47) ndjekin studimet me korrespondencë. Sipas ekipit të ekspertëve, rregullorja për studimet bachelor nuk përcakton se çfarë është mënyra e studimeve me korrespondencë as si duhet të organizohet ajo.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Hulumtimi”, në raportin e vlerësimit ekspertët kanë theksuar se Kolegji Tempulli nuk ka Plan për Zhvillim të Hulumtimit. Aktivitetet e planifikuara në Planin për Zhvillim

Strategjik të Kolegjit 2020-2024, për fushën e hulumtimit, janë shumë të përgjithësuara dhe nuk kanë objektiva konkrete dhe tregues të qartë. Sa i përket publikimeve të stafit akademik të kolegjit Tempulli, ekspertët kanë gjetur se disa mësimdhënës kanë publikuar punimet e tyre në revista që nuk janë të indeksuara në asnjë platformë të rëndësishme si dhe janë të renditura në liste e revistave të dyshimta. Nga intervista me mësimdhënës dhe bartës të programeve u kuptua se pritjet për përfshirje të stafit mësimdhënës në aktivitete kërkimore nuk janë të përcaktuara qartë. Sipas ekspertëve të akreditimit, stafi akademik i kolegjit Tempulli dedikon vetëm 10% të kohës së punës në aktivitete kërkimore, dhe kjo përgjigje është dhënë edhe nga stafi i rregullt i Kolegjit të cilët nuk kanë pasur orë mësimore/ligjërata në këtë vit akademik.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional”, ekspertët kanë gjetur se kolegji Tempulli ka zhvilluar një manual të punësimit i cili është i qasshëm për të gjithë stafin akademik dhe administrativ. Megjithatë ky manual përmban informata të shumta për procesin e rekrutimit, orarin e punës, pushimet, etj., aty mungojnë informata të rëndësishme që kanë të bëjnë me përgjegjësitë, mbikëqyrjen, vlerësimin e performancës, avancimin, proceset mbështetëse dhe zhvillimin profesional. Sipas ekipit të ekspertëve, kriteret dhe proceset për vlerësim të performancës nuk janë të përcaktuara qartë dhe stafi nuk është njoftuar paraprakisht për to.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Burimet dhe hapësirat”, në raportin e vlerësimit ekspertët kanë deklaruar se megjithatë për momentin hapësirat e kolegjit Tempulli janë të mjaftueshme për numrin e studentëve që ka të regjistruar, kjo hapësirë nuk është e mjaftueshme për planet e Kolegjit për rritje të numrit të studentëve dhe stafit. Sa i përket bibliotekës së Kolegjit, ekspertët kanë konstatuar se Tempulli ende nuk ka literaturë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e programeve dhe aktiviteteve kërkimore të organizuara në institucion.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Bashkëpunimi institucional”, ekipi i ekspertëve ka potencuar se gjatë bisedave me mësimdhënës dhe me bartësit e programeve u bë e qartë se ata nuk e dinë kush është i emëruar dhe përgjegjës për marrjen e iniciativave dhe arritjen e rezultateve në fushën e internacionalizimit. Kolegji tempulli shumë rrallë merr pjesë në projekte kërkimore ndërkombëtare. Raporti i vet-vlerësimit përmend një projekt që është zbatuar gjatë periudhës 2009-2011 dhe një tjetër gjatë 2012-2014. Gjatë bisedave me mësimdhënësit dhe bartësit e programeve ekspertët nuk kanë arritur të marr informata të mjaftueshme lidhur me atë se si është përfshirë në kriteret për avancim dhe vlerësim të performancës angazhimi në bashkëpunime ndërkombëtare. Në këtë kontekst ekipi i ekspertëve ka konstatuar se kolegji Tempulli nuk ka asnjë mekanizëm për të përkrahur bashkëpunimin me institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë, dhe asnjë lloj përkrahje nuk i ofrohet stafit akademik për zhvillimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me komunitetin ndërkombëtar.

Prandaj, duke u bazuar në gjetjet e ekspertëve si dhe në rekomandimin final të tyre për mos akreditimin e Kolegjit të Shkencave të Aplikuara “Tempulli”, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Dr. Gazmend Lumbani
Kryetar i Këshillit Shpirtëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit të Shkencave të Aplikuara "Tempulli"
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.